

## I. SONDAZHI KOMBËTAR I STUDENTËVE

Një nga mekanizmat kryesorë të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë në vendin tonë është matja e kënaqshmërisë së studentëve nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve (SKS). Kjo metodë përdoret për të nxjerrë informacione të nevojshme për funksionimin e arsimit të lartë në tërësi apo të veprimtarive akademike në Institucionet e Arsimit të Lartë.

SKS është proces i cili ka në qendër studentin dhe ka si qëllim kryesor vlerësimin dhe matjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancën e Institucioneve të Arsimit të Lartë në veprimtaritë e mësimdhënieve, mësimnxënies, kompetencave dhe mbështetjes ndaj studentëve.

Të dhënat e nxjerra nga ky Sondazh do të shërbejnë përmarrjen e vendimeve të rëndësishme në hartimin e politikave shtetërore në fushën e Arsimit të Lartë dhe kërkimit shkencor me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë në Arsimin e Lartë.

Sondazhi organizohet dhe monitorohet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), në bashkëpunim me Institucionet e Arsimit të Lartë (Universitetet; Kolegjet Universitare; Akademitë; Kolegjet Profesionale të Larta) dhe Këshillat Studentore/Qeveritë Studentore.

### SKS është i rëndësishëm sepse:

- ✓ Jep informacione reale e të besueshme për cilësinë e Arsimit të Lartë, bazuar tek mendimi dhe opinioni i studentëve.
- ✓ Ndihamon vetë institucionet në përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së tyre.
- ✓ I jep informacionet e nevojshme drejtuesve/titullarëve të institucioneve për hartimin e politikave të zhvillimit të institucioneve, bazuar në nevojat dhe kërkosat e studentëve.
- ✓ Informon studentët aktualë për cilësinë e Arsimit të Lartë në institucionet ku ata studiojnë.
- ✓ Informon studentët e rinj për cilësinë e mësimdhënieve në institucionet ku ata dëshirojnë të ndjekin studimet e tyre.
- ✓ Informon publikun në tërësi për cilësinë e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.

## II. PËRMBAJTJA E SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

Vlerësimi nëpërmjet SKS bazohet në një pyetësor, plotësimi i të cilin nuk zgjat më shumë se 5 minuta. Duke i'u përgjigjur pyetjeve, studentët do të jen mendimin për 6 (gjashtë) kategoritë e mëposhtme:

### 1. Mësimdhënia dhe mësimnxenia

Në këtë kategori studentët do të kenë mundësi që të përgjigjeve mbi informacionet që ata kanë, të jen mendimin dhe vlerësimin e tyre mbi trupën pedagogjike, psh. përaftësitet e tyre në shpjegimin e njohurive, koncepteve dhe metodave që përdorin gjatë leksioneve të ndryshme.

Studentët do të pyeten dhe përmbla materialet që ju vihen në dispozicion nga pedagogët, njohuritë që marrin nga programi i studimit që ata ndjekin, zbatueshmërinë e pjesës teorike në praktikë, etj.

### 2. Vlerësimi dhe feedback-u

Me pyetjet e kësaj kategorie, studentët kanë mundësi të përgjigjen përmblësive transparencën, paanësinë në vlerësimin e pedagogëve për studentët, përdetyrat e ndryshme, esetë, provimet e ndërmjetme dhe vlerësimin final të lëndës.

Studentët gjithashtu do të kenë mundësi të jen mendimin e tyre në lidhje më komunikimin që kanë me pedagogët, mbështetjen që marrin prej tyre, sa të shpeshta i kanë kontaktet me ta në rast të pyetjeve që mund të kenë, problematikave, etj.

## 3. Burimet në funksion të mësimdhënieve

Këto përfshijnë burime si: **infrastruktura fizike** (salla leksioni, seminari, ambiente sportive, ambiente gjodhëse, etj.); **infrastruktura didaktike** (laboratorë, biblioteka, internet, etj.); **mundësítë fizike dhe financiare** që jep Institucionit përmarrje të ndryshme studentore (psh. përbledhjet e Qeverisë/Këshillit Studentor, aktivitete sociale, kulturore, sportive, etj.).

Kjo do të thotë nëse institucioni ju mundëson financime apo ju vë në dispozicion bazë materiale si laboratore, kompjutera, tekste të ndryshme, etj.

### 4. Organizimi dhe realizimi i programeve të studimit

Kjo kategori përmban pyetje mbi informacionin që studentët kanë përmblësive përmjet e programit të studimit.

Studentët kanë mundësi të përgjigjen përmblësive njohuritë që ata kanë, çfarë lëndësh zhvillohen në programin e studimit që janë duke ndjekur, si është e organizuar secila lëndë në leksione, seminare, praktikë, detyra kursi, mënyra e vlerësimit, provimet, temat që trajtohen në çdo orë leksiuni, tekstet që ju nevojiten përmblësive, leksionet që ju jepen nga pedagogët, literatura ndihmëse, seminarët, etj.

### 5. Mbështetja dhe zëri i studentëve

Në këtë kategori studentët jen mendime dhe vlerësimi përmblësive informacionin që kanë përparrë regjistrimit në Institucion, mbështetjen që jen zyrat e ndryshme administrative gjatë kryerjes së studimeve, lehtësirat financiare që mund të përfitojnë si dhe rastet e mënyrat e përfitimit të tyre.

Studentët gjithashtu mund të vlerësojnë masat konkrete dhe përpjekjet që bën Institucionit përmblësive lidhjen e tyre me tregun e punës dhe ofertat e punësimit.

Studentët do të shprehen nëse institucioni merr mendimin e studentëve nëpërmjet pyetësorëve online ose me shkrim, fokus grupave, përcilësinë e mësimdhënieve, infrastrukturës, përfshirjen në aktivitete kërkimore-shkencore, etj.

## 6. Vlerësimi i përgjithshëm i programit të studimit/institucionit

Në këtë kategori studentët jen mendime dhe vlerësimi përgjithshëm mbi programin e studimit/institucionin, stafin ndihmës akademik, stafin ndihmës akademik etj.

Studentët gjithashtu do të vlerësojnë në tërësi dhe shprehin mendimin e tyre përmblësive përmjet e strukturën e institucionit ku ndjekin studimet.

Të njëjtat kategori dhe pyetje do të përdoren përmblësive përmjet e gjithë institucionet që do t'i nënshtronë vlerësimin e mësimdhënieve, pavarësisht madhësise, historikut apo statusit të tyre.

## III. ZHVILLIMI I SONDAZHIT KOMBËTAR TË STUDENTËVE

Është e rëndësishme që pjesëmarrja në SKS të jetë maksimal, në mënyrë që çdo student të shprehë mendimin e tij përmblësive përmjet e gjithë institucionit ku ka zgjedhur të studioj.

Meqëndëshe SKS është një proces i cili bazohet mbi mendime dhe opinione të studentëve përmblësive përmjet e gjithë institucionit ku ata studiojnë, është gjithashtu e rëndësishme që studentët të ketë njohuri përmblësive përmjet e gjithë institucionit dhe të jen përmblësive mendimin e tij pavarësisht apo opionin e tjerë.

Pyetësori zhvillohet online nëpërmjet platformës që disponohen përmblësive përmjet e gjithë institucionit.

Gjatë fazës së plotësimit të pyetësorëve, institucionet vënë në dispozicion të studentëve, salla dhe laboratorë informaticë. Gjatë periudhës 21 Prill 2025 – 23 Maj 2025 studentët do të njoftohen nëpërmjet e-mail përmblësive përmjet e gjithë institucionit. Studentët kanë mundësi t'a plotësojnë atë në çdo kohë nga çdo ambient, si nga aparatet e ndryshme celular, ashtu edhe nga sallat e kompjuterave të vëna në dispozicion nga institucionet. Në këto raste, procesi do të monitorohet nga ASCAL dhe në sallë gjatë orarit të caktuar, nuk do të ketë asnjë përfaqësues nga pedagogët apo stafi tjetër i institucionit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Studentët vlerësojnë



## SONDAZHI

KOMBËTAR I STUDENTËVE,  
**2024-2025**

Broshurë informuese



Këshillat Studentorë/Qeveritë Studentore kanë një rol të rendësishëm për informimin e studentëve për rendsinë e procesit, për përgjegjësinë ndaj institucionit për të dhënë përgjigje të sakta dhe reale, për afatet e plotësimit si dhe informimin me rezultatet përfundimtare. Për çdo informacion Këshillat Studentorë/Qeveritë Studentore, duhet t'i drejtohen Koordinatorit Institucional i cili është person kontakti për ta.

Studenti mund të zgjedhë si përgjigje **më shumë se një** alternativë, si dhe në disa pyetje është lënë mundësia për dhënien e një **teksti** të shkurtër përshkrimor.

Në përgjithësi pyetjet janë të organizuara në mënyrë të tillë që studenti të japë mendim ose vlerësim të klasifikuar në **5 dhe 6 nivele** (në disa raste) duke filluar nga vlerësimi *minimal tek ai maksimal*.

### Konkreksht:

- Vlerësimi 1 – aspak dakord / shumë keq
- Vlerësimi 2 – përgjithësisht nuk jam dakord / keq
- Vlerësimi 3 – as po as jo / as mirë as keq
- Vlerësimi 4 – përgjithësisht dakord / mirë
- Vlerësimi 5 – plotësisht dakord / shumë mirë
- Vlerësimi 6 – Nuk kam informacion të mjaftueshëm

### IV. TRANSPARENCA, ANONIMATI DHE KONFIDENCIALITETI

- ✓ Procesi i plotësimit të pyetësorit është **anonim** dhe bazohet tërësisht në **opinionin individual** të **studentëve** për Institucionin ku ata studiojnë.
- ✓ Përpala plotësimit të pyetësorit, çdo student ka të drejtë të jetë i mirëinformuar në lidhje me këtë Sondazh, mënyrën e organizimit të tij dhe qëllimin për të cilin ai realizohet.
- ✓ SKS do të ofrohet në **tre gjuhë (shqip, anglisht dhe italisht)** për tu dhënë mundësi plotësimi studentëve vendas dhe të huaj.
- ✓ Pyetësori kërkon të mbledhë mendimin e studentit për Institucionin. Përgjigjet janë individuale dhe anonte.
- ✓ Të dhënat për studentët (emri dhe e-mail) sigurohen zyrtarisht nga institucionet e arsimit të lartë ku studentët ndjekin studimet. Emri dhe e-mail i çdo studenti përdoren vetëm për dërgimin e pyetësorit në llogarinë e tij (**link-u** për akses të pyetësorit dhe **kodi** për akses).
- ✓ Analiza e përgjigjeve kryhet në mënyrë statistikore. Në asnjë rast nuk identifikohet përgjigja me emrin e individit. Çdo individ i merret mendimi vetëm njëherë në një pyetësor të caktuar.
- ✓ Informacionet e mbledhura trajtohen në përputhje me legjislacionin shqiptar të arsimit të lartë dhe ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

### V. REZULTATET DHE RAPORTI PËRFUNDIMTAR



Realizimi i SKS është detyrim ligjor në kuadër të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe për këtë arsy Marrin pjesë të gjithë studentët nga të gjitha universitetet, kolegjet universitare, akademitë dhe kolegjet profesionale të larta që operojnë në Republikën e Shqipërisë apo filiale të institucioneve të huaja të licencuara në vendin tonë



Në përfundim të procesit hartohet raporti analistik me rezultatet e pyetësorit, shoqëruar me analizat përkatëse për institucionet e ndryshme për t'ju përgjigjur interesit publik apo të politikëbërjes.



Ky raport publikohet në faqen zyrare të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), i dërgohet institacioneve përkatëse si dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

### VI. PËRMBYLLËSE

Studentët gjatë gjithë procesit kanë asistencën e nevojshme për sqarime, informacione dhe suport teknik nga Grupi i Punës, stafi i ASCAL dhe Koordinatori i Institucionit. Në dispozicion të studentëve vihet ky udhëzues, informacione dhe portali online për sqarimet e duhura.

Institucionet duhet të janë të ndërgjegjshme në lidhje me rendsinë që ka aktivizimi i studentëve si dhe nevojën për përfaqësimin e gjerë të tyre. Ato krijojnë dhe ofrojnë të gjitha lehtësirat e duhura për studentët për plotësimin e SKS në ambiente të posaçme, nëse është e nevojshme.



MË SKANO

Agjencia e Sigurimit të  
Cilësisë në Arsimin e Lartë

Rr. e Durrësit, nr. 219, Tiranë  
Phone: +355 4 222 43423  
E-mail: info@ascal.al  
Web: www.ascal.al